



Tiranë, më 09.11.2019

## REZOLUTË

### “PËR RITJES E PAGËS MINIMALE DHE PËRCAKTIMIN E MINIMUMIT JETIK ZYRTAR”

Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë e ka konsideruar rritjen e pagave në tërësi dhe atë të pagës minimale dhe përcaktimin e minimumit jetik në veçanti, jo si një apstraksion ekonomik, por si një burim jetësor i domosdoshëm për punëtorët dhe qytetarët. Aktualisht paga minimale në Shqipëri është 26 mijë lekë, e cila jepet për 174 orë pune në muaj, me pagë bazë minimale orare 149 lekë. Kjo pagë jepet për 156 mijë të punësuar, ose 29.6 % e totalit të të punësuarve. Në sektorin publik me këtë pagë paguhen vetëm 1% e punonjësve, pjesa tjetër i përkasin sektorit privat.

Këto shifra vërtetojnë qartë se kjo pagë minimale është nën “normat e tregut” dhe si e tillë ajo tashmë ka krijuar pakënaqësi, demotivim dhe shpesh kundërshti e konflikte sociale. Të ndodhur në këto rrethana, si dhe në respektim të Konventës 131 të ILO-s për pagën minimale dhe në zbatim të Nenit 4 të Kartës Sociale Europiane (e nënshkruar nga shteti ynë), e cila thekson se “Nuk konsiderohet në përputhje me kartën nëse paga minimale zbret nën 60 % të pagës mesatare neto kombëtare”, Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë i kërkon Qeverisë Shqiptare rritjen e pagës minimale në 33 mijë lekë që nga Janari 2020 dhe në 26 mijë lekë nga Janari 2021, si dhe shpalljen e minimumit jetik zyrtar. Kërkesa jonë ka bazueshmëri dhe logjikë ekonomike, e cila lidhet me aftësitë konkurruese të ekonomisë tonë. Kjo kërkesë merr parasysh edhe ndryshimin e dinamikës së përgjithshme të pagave që pësohet nga kjo rritje, normën e inflacionit nga viti në viti, si dhe aftësitë e buxhetit të shtetit për të përballuar këtë rritje (për punonjësit buxhetor), si dhe me aftësinë konkurruese të pagave të bizneseve vendase dhe të huaja që operojnë në Shqipëri në sektorin privat.

Rritja e pagës minimale dhe miratimi zyrtar i minimumit jetik bëhet domosdoshmëri, jo vetëm për të ri-rregulluar shpërndarjen e produktit në të gjithë piramidën e sistemit të pagave dhe shpërblimeve sociale, por ajo nxit rritjen e pensioneve, favorozon punësimin, rrit ndihmën ekonomike, pagesat e paaftësisë dhe përfitime të tjera bazike, të cilat fatkeqësisht në mënyrë të frikshme po e rrisin nivelin e varfërisë në shtrirje dhe në thellësi.

Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë e shikon si prioritet të saj rritjen e pagës minimale pasi ajo shërben për rritjen dhe përmirësimin zinxhir të pagës reale, mbështetjen e pagës tek produktiviteti, nxitjen dhe zhvillimin e dialogut social më efektiv, me synim adaptimin më të mirë të gjithë politikës së pagave.

Rritja e pagës minimale do të japë direkt efekte pozitive në uljen e varfërië monetare duke rritur të ardhurat dhe për rrjedhojë duke nxitur dhe rritur konsumin. Nëpërmjet uljes së varfërisë monetare do të kemi një vlerësim real të çmimit të krahut të punës, do të kemi rritje të produktivitetit të punës, duke e bërë punën dinjitoze dhe nëpërmjet saj duke kontribuar direkt në përmirësimin e cilësisë së jeteës, në shëndetin e njerëzve, edukimin, arsimimin, punësimin, përfshirjen sociale, garantimin e lirisë dhe të shprehjes për përfaqësuesit e punëtorëve.

**Miratuar në Kongresin e 6-të të KSSH-së.**